

Nr. 3040 prot.  
24. 11. 2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

AMENDAMENT I DEPUTETIT

**TITULLI I AMENDAMENTIT:** RRIJA E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR  
RIMBURSIMIN E BARNAVE TË QYTETARËVE TË  
INFEKTUAR ME COVID-19.

**KËRKUES:** Z. PETRIT VASILI

Deputet i Kuvendit të Shqipërisë

**OBJEKTI:** “PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKT- LIGJIN -  
BUXHETIN E VITIT 2022”

**BAZA LIGJORE:** Neni 75 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

**ARGUMENTIMI I PROPOZIMIT:**

Shqipëria vazhdon të përballet me pandeminë e COVID-19 dhe mijëra qytetarë për arsyen ekonomike e kanë të pamundur të blejnë barna për trajtimin e sëmundjes, edhe aktualisht numri i përditshëm i rasteve të reja të të infektuarëve me COVID-19 vazhdon të jetë i lartë me një mesatare rreth 500 raste në ditë, që do të thotë mijëra raste të reja në çdo muaj.

Gjithashtu, kujtojmë se Europa po përballet më një valë të re serioze të përhapjes së COVID-it dhe shifrat flasin qartë se edhe Shqipëria po përballet me një shtim serioz të rasteve. Deri më tani, vetëm sipas shifrave zyrtare janë rreth 200.000 të infektuar, ndërkokë është e njojur publikisht që raste reale janë shumë herë më të larta se kaq.

Deri më tani, nga xhepat e Shqipëtareve kanë dalë mbi 180 milion euro për trajtime mjekësore që lidhen me COVID. Shteti dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kanë rimbursuar rreth 8000 qytetarë për një vlerë rreth 32 milion lekë ose afersisht 320.000 dollarë.

Pikërisht për këtë arsy, kërkojmë një shtesë prej 2 miliard lekë si shtesë në Buxhetin e vitit 2022 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, me destinacion rimbursimin e barnave për të sëmurët e infektuar me COVID-19.

#### **PËR KËTO ARSYE:**


Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqiperisë, ku specifikohet se: “*Çdo deputet ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të paraqësë në seancë plenare amendamente për projektligjin ose ndryshimet e propozuara nga komisioni përgjegjës, me kusht që ato të janë të regjistruara paraprakisht në sekretari të paktën 24 orë para fillimit të seancës plenare dhe tu janë shpërndarë deputetëve të tjera*”, parqes amendamentin sipas Aneksit 1 bashkëlidhur. Ky amendament do të prezantohet nga një deputet.

Duke e vlerësuar shumë të rëndësishme zhvillimin e shëndetësisë, si dhe duke e vlerësuar si thelbësore për ruajtjen e marrëdhënieve së besimit midis shtetit dhe qytetarëve, duke përfshirë edhe përgjegjshmërinë e Qeverisë në mbajtjen e premtimeve elektorale, propozoj miratimin e këtij amendamenti në seancë plenare.

#### **DEPUTETI:**



(emër, mbiemër, nënshkrimi)



## **ANEKSI 1**

Në projektligjin “Për buxhetin e vittit 2022”, të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

### **Neni 1**

Në nenin 1 , të shtohet pika “Te krijohet një shtesë në buxhetin e vittit 2022 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, prej 2 miliard lekë me destinacion rimburësimin e barnave për të sëmuret e infektuar me Covid-19”.

Kjo shtesë pasqyrohet në të gjitha nenet dhe anekset e ligjit.